



Kryetari i Komunës së Klinës  
01 Nr. 320-7777/19  
Më 25.02.2019

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 8 dhe 17, shkronjën (f) të ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve Nr. 02/L-10 ( Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, 28/2018), nenit 13 dhe shkronjës d, të nenit 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", më dt.04.06.2008, nr.28/75, nenit 91, paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Klinës, të dt.07.04.2010. Kryetari i Komunës së Klinës nxjerr këtë:

## URDHËRESË

### PËR NDALIMIN E VRASJES, KEQTRAJTIMIT DHE ORGANIZIMIN E GARAVE TË KUNDËRLIGJSHME TË KAFSHËVE

**I. NDALOHET** vrasja keqtrajtimi, eksperimentimi i kafshëve pa licence, operimit kirurgjik më qellim të modifikimit të dukjes së kafshës, më të largohen apo dëmtohet cila do pjese e trupit, importimi dhe shitja e kafshëve agresive, tregtimi i kafshëve në kundërshtim më dispozitat ligjore, organizimi i garave në të cilat testohet fuqia apo shpejtësinë e kafshës më ç rast kafsha mund të pësoj dhembje, lëndime, ngordhje apo bën organizimin e tyre në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe përdorimin i substancave për kafshët që marrin pjese në garat cilat nuk janë të përcaktuara me dispozitat ligjore.

**II. SUBJEKTET** të cilat bien në kundërshtim me këtë urdhëresë do të nënshtrohen me gjobë nga 100. / euro (njëqind euro) deri në 5.000.- euro (pesëmijë euro), sipas dispozitës së nenit 17 të Ligjit për Përkujdesjes ndaj Kafshëve.

**III. ZBATIMIN** e kësaj urdhërese do ta bëj Inspektorati i Komunës së Klinës ne bashkëpunim më Drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**V. URDHËRESA** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**VI. URDHËRESA** ju dërgohet :

- Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Inspektoratit të Komunës
- Arkivit



Kryetari i Komunës së Klinës  
Prof. Dr. Zenun Elezaj